



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUIJË
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Krujë Qëndër, Sheshi Skënderbej, tele 051122170 e-mail: infokruja@gov.al

N³⁹³⁶ Prot

Datë: 11.06.2021

Lenda: Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Krujë.

Drejtuar: Z. Artur Bushi
Kryetar i Bashkisë

Për dijeni: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Këshilli Bashkiak Krujë, në bashkëpunim me Projektin Bashki të Forta, ka hartuar një pyetësor me anë të së cilit synon të mbledhë mendimin e komunitetit mbi mënyrën sesi bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2020 dhe të kuptojë prioritetet e komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2022-2024. Sondazhi është ndërtuar mbi bazën e rezultateve të Raportit të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë për vitin 2020.

Pyetjet e sondazhit janë ngritur mbi të dhënat faktike të vitit 2020 në lidhje me peshën e buxhetit që ka harxhuar bashkia për shërbimet / funksionet kryesore që ofrohen si:

- Kujdesi për familjet dhe fëmijët;
- Menaxhimi i bashkisë dhe administratës së saj;
- Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor;
- Rrjeti rrugor rural;
- Shërbimet publike vendore;
- Furnizimi me ujë.

Sondazhi gjithashtu pyet komunitetin në lidhje me gadishmërinë e tij për të paguar më shumë tarifa për të përmirësuar apo rritur shërbimet që i ofrohen sot si edhe për të vlerësuar punën e kryetarit aktual të bashkisë.

Deri më datë 2 Qershor 2021 pyetsorin e kanë plotësuar 117 persona të komunitetit të bashkisë Krujë nga të cilët 69 femra dhe 48 meshkuj në një raport 59% me 41%. Ndër ta, 56% e kanë vizituar / lexuar Buxhetin Interaktiv të Raportit të Performancës 2020 (elektronik) dhe e vlerësojnë informacionin që ai jep si mjaft të dobishëm (duke i dhënë notën 4,39 nga 5 maksimumi).

Të pyetur në lidhje me mënyrën sesi sugjerojnë pjesëmarrësit në pyetësor për financimin e funksioneve / shërbimeve që ofron bashkia të cilat në buxhetin e vitit 2020 zinin më pak se 3% të tij, ata janë përgjigjur se kanë disa prioritetet të identifikuar si më poshtë:

- Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara;
- Ujitja dhe kullimi;

- Arsimi i mesëm i përgjithshëm;
- Strehimi;
- Kujdesi parësor shëndetsor;
- Sport dhe Argëtim;
- Ujrat e zeza dhe kanalizimet;
- Turizmi;
- Mbështetje për zhvillimin ekonomik;
- Shërbimet bujqësore;
- Planifikimi urban;
- Trashëgimia kulturore;
- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile;
- Policia vendore;
- Marrëdhëniet me komunitetin;
- Pyjet dhe kullotat.

Duket qartazi se prioritetet e shumicës së pjesëmarrësve në sondazh janë:

- Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara;
- Ujitja dhe kullimi;
- Arsimi i mesëm i përgjithshëm.

Për sa më sipër, Komisioni i Ekonomisë dhe Financës i mbledhur më datën 11/06/2021, pasi shqyrtoi rezultatet e pyetësorit të prioritetëve të komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2022-2024, me anë të kësaj shkrese ju përcjellë kërkesat e qytetarëve që dalin nga pyetësori i organizuar nga Këshilli Bashkiak.

Lutemi, përfshirjen e tyre si pjesë të Projekt Buxhetit 2022-2024 brenda kapaciteteve financiare dhe prioritetëve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj në lidhje me kërkesat e komunitetit sa më sipër.

Bashkangjitur raporti i plotë i pyetësorit.

Kryetar i Këshillit: Besa Sheta

Besa Sheta

Sekretari i Këshillit: Gjon Lata

Isuf Boku
mirat

Kryetar Komisionit: Lutfi Zherri

Nenkryetare Komisionit: Astrit Llubani

Astrit Llubani

Anetare Komisionit: Lida Çela

Lida Çela

Anetare Komisionit: Shpresa Qira

Shpresa Qira

Anetare Komisionit: Mirjeta Sukthi

Pendimont Kolli
Xherdet Shulla
Murat Maroti
Fatme Barri
Deshire Karruke